

DOKUMENT POLITIKASH

Perceptimet mbi korrupsionin në universitetet e Shqipërisë, Maqedonisë Veriore dhe Serbisë: Perspektivat e studentëve

Parathënie


Në periudhën 2023-2024 Instituti për Kërkime Strategjike dhe Edukim – ISIE (Shkup) në bashkëpunim me Institutin për Kërkime Zhvillimore dhe Alternativa – IDRA (Tiranë) dhe Qendrën për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci – CESID (Beograd) po zbatojnë projektin rajonal ‘Universitete pa Korrupsion në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi’. Projekti synon forcimin e kapaciteteve të universiteteve, organizatave studentore dhe studentëve për parandalimin e korrupsionit në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në tre vendet e synuara. Nëpërmjet një sërë aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë përgatitjen e Raportit të Përbashkët për perceptimin e korrupsionit, organizimin e tryezave të rumbullakëta, seminare për ngritjen e kapaciteteve, shkolla verore dhe zhvillimin e një softueri digjital në formën e një asistenti virtual (chatbot), projekti do të nxisë një mjedis që mundëson parandalimin e korrupsionit në fushën e arsimit të lartë në vendet e synuara të Ballkanit Perëndimor.

Ky dokument politikash paraqet rezultatet kryesore nga anketa e perceptimeve të studentëve të kryer në të tre vendet. E kryer për herë të parë, kjo anketë është kryer në mbi 10 qytete duke përdorur teknikën intervistave ballë për ballë në maj të 2023, me një kampion prej 943 studentësh nga të tre vendet së bashku. Informacion më të detajuar mund të gjendet në raportet kombëtare që mund të aksesohen në faqen tonë të internetit www.corruptionfreeuni.com.

Gjetjet kryesore nga anketa


Pothuajse një e katërta e të anketuarve nga Serbia (24%) e panë korrupsionin në fakultetet e tyre si shumë ose jashtëzakonisht të zakonshëm. Ndërsa një e pesta e të anketuarve (20%) nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut mendojnë se korrupsioni është shumë ose jashtëzakonisht i zakonshëm në fakultetet e tyre.

Grafiku 1 – Sa i zakonshëm është korrupsioni në fakultetin tuaj? (%)




Sjelljet e padëshirueshme më të shpeshta në fakultete janë mashtrimi i studentëve në provime (Serbia dhe Maqedonia e Veriut), profesorët që kushtëzojnë studentët për të blerë librin e tij/saj për të kaluar provimin ose për të marrë një notë më të mirë (Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut) dhe dhënia e parave profesorëve për nota më të larta (Shqipëria dhe Serbia). Studentët nga Shqipëria më shumë se të tjerët janë përgjigjur se nuk dinë çfarë përgjigje të japin.

Grafiku 2 – Cila sjellje e padëshiruar është më e përhapur në fakultetin tuaj? (%)




Studentët shqiptarë më shpesh kanë deklaruar se kanë përjetuar nevojën për të dhënë ryshfete që iu kërkohet nga profesorët/ stafi i fakultetit. Një në 10 studentë kanë thënë se u është kërkuar ryshfet. Të anketuarit nga Maqedonia e Veriut gjithashtu deklaruan se u është kërkuar nga profesorët të japin ryshfet relativisht më shumë (9%).

Grafiku 3 – Që nga fillimi i arsimit tuaj në këtë fakultet, a keni qenë ndonjëherë në një nga situatat e mëposhtme: Përgjigjet: Po, të paktën një herë (%)




Ndonëse shumica e studentëve të intervistuar nuk kanë raportuar për korrupsion deri më tani, studentët nga Shqipëria i kanë raportuar më shpesh këto raste – 7%.

Grafiku 4 – A keni raportuar ndonjëherë ndonjë rast korrupsioni tek menaxhmenti i fakultetit, qoftë zyrtarisht ose jozyrtarisht? (%)




Shumica e të anketuarve thanë se ose nuk dinë se si të përgjigjen ose mendojnë se nuk ka një zyrë në fakultet të dedikuar për raportimin e korrupsionit. Kjo lidhet veçanërisht me përgjigjet nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Nga ana tjetër, një e pesta e të anketuarve nga Shqipëria (21%) janë në dijeni për zyrën e cila ka për qëllim marrjen e raporteve të studentëve për korrupsion. Në Serbi, 57% e personave thonë se nuk e dine nëse fakulteti i tyre ka një zyrë të dedikuar për raportime korrupsioni. Studentët nga Shqipëria janë përgjigjur më shpesh se kanë dëgjuar ose parë një raport korrupsioni të injoruar ose keqmenaxhuar nga menaxhmenti i fakultetit (23%) në krahasim me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

Grafiku 5 – A keni dëgjuar ose dëshmuar ndonjëherë një raport korrupsioni të injoruar ose keqtrajtuar nga menaxhimi i fakultetit? (%)



Studentët nga universitetet serbe më shpesh (pothuajse 61%) janë përgjigjur se nuk janë në dijeni fare për procedurën e raportimit të korrupsionit në fakultetet e tyre. Nga ana tjetër, studentët nga Shqipëria janë relativisht më të informuar se të tjerët për procedurat e raportimit të korrupsionit.

Grafiku 6 – Cila është arsyeja kryesore e nivelit të ulët të raportimit të korrupsionit në fakultetin tuaj? (%)



Përgjigjet nga të treja vendet janë të ndryshme kur bëhet fjalë për arsyen kryesore pse korrupsioni është shumë pak raportuar. Studentët e intervistuar nga Maqedonia e Veriut deklaruan se arsyeja është hakmarrja ndaj atyre që raportojnë (33%). Studentët nga Shqipëria fillimisht përmendën procedura të paqarta (24%). Studentët nga Serbia përmendën kryesisht interesin e mangët për eliminimin e korrupsionit (20%).

Rekomandime

SHQIPËRIA

Rekomandime në kuadër të nivelit institucional (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

- Sugjerohet fuqimisht që Ministria e Arsimit dhe Sportit të bashkëpunojë me OSHC-të dhe palët e tjera të interesit, dhe të shfrytëzojë më tej këtë temë, të identifikojë problemet në këtë sektor dhe të zhvillojë një qasje më proaktive drejt parandalimit të korrupsionit në institucionet e arsimit të lartë

Rekomandime mbi kuadrin ligjor për Institucionet e Arsimit të Lartë

- IAL-të duhet të orientohen për të bashkëpunuar me Ministrin e Shtetit për Ofrimin e Shërbimeve dhe Standardet që ka për detyrë të hartojë, koordinojë dhe zbatojë politikat shtetërore, duke lehtësuar ofrimin e shërbimeve publike duke siguruar cilësinë, përbalueshmërinë dhe rritjen e
- efektivitetit të tyre, rrjedhimisht përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptarë. Në këtë kuadër, IAL-et sugjerohen të zbatojnë mjetet e menaxhimit të cilësisë, në këtë rast specifik, miratimin e ISO37001, si një instrument vendimtar kundër rryshfetit.
- IAL-ve u sugjerohet me shumë seriozitet të zhvillojnë planet e tyre të integritetit si pjesë e masave kundër korrupsionit. Ata duhet të zhvillojnë një qasje/politikë të vlerësimit të riskut, duke synuar identifikimin dhe vlerësimin e tyre dhe zhvillimin e masave lehtësuese për secilin prej tyre.
- IAL-të do të zhvillojnë mekanizma të brendshëm për të garantuar zbatimin e Rregullores për Konfliktin e Interesit dhe Rregulloren për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Monitorimi periodik i nivelit të zbatimit dhe përputhshmërisë është thelbësor dhe duhet të kryhet rregullisht.
- Organizimi i sesioneve informuese apo fushatave sensibilizuese mund të jenë instrumente të dobishme për të promovuar këto zyra duke synuar efikasitetin e tyre.

Rekomandime lidhur me perceptimet e studentëve lidhur me korrupsionin

- Ekziston nevoja për të rritur ndërgjegjësimin mbi korrupsionin, duke organizuar evente të ndryshme dhe periodike për studentët, duke synuar një kuptimi më të mirë të praktikave korruptive dhe sesi studentët mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në adresimin e tyre dhe minimizimin e korrupsionit.
- Zhvillimi i procedurave standarde të funksionimit mbi raportimin e sjelljeve të padëshiruara është një element kyç për t'u marrë në konsideratë seriozisht nga IAL-të.
- IAL-të duhet të marrin masa konkrete për të rikthyer besimin e studentëve për raportimin e praktikave korruptive duke

përfshirë sesionet periodike të informimit, prezantimin e procedurave të raportimit, prezantimin e rasteve konkrete të raportimit etj.

- IAL-ve u rekomandohet me shumë seriozitet të krijojnë një mjedis komod (sesione informimi, informime, organizim të forumeve të studentëve, prezantim të rasteve konkrete të raportuara, etj) për studentët dhe t'i inkurajojnë ata të raportojnë çdo sjellje të papërshtatshme. Sugjerohen gjithashtu sondazhe të rregullta në online.

MAQEDONIA E VERIUT

- Hartimi i Manualit për Parandalimin e Korrupsionit në Arsimin e Lartë, i cili do të përmbajë të gjithë mekanizmat për raportimin e korrupsionit, mënyrën e hedhjes së raportit, si dhe autorizimet e institucioneve kompetente lidhur me raportimet.
- Mbajtja e një kursi trajnimi për studentët, punonjësit dhe organizatat studentore mbi mënyrën se si të raportojnë korrupsionin.
- Krijimi i një skedë të veçantë në faqen e fakultetit e cila do të përmbajë të gjitha informacionet dhe dokumentet e hartuara me qëllim parandalimin e korrupsionit.
- Bërja e dallimit midis raporteve të korrupsionit dhe raporteve të sinjalizuesve nga persona të tjerë.
- Mbajtja e më shumë aktiviteteve të cilat do të kontribuonin në forcimin e sistemit të AL dhe edukimit me integritet dhe cilësi.

SERBIA

1. Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i mekanizmave kundër korrupsionit

- Adaptimi dhe përmirësimi i rregullave lidhur me sjelljet akademike të papërshtatshme;
- Të merren në konsideratë forma dhënie provimesh që synojnë të reduktojnë përdorimin e teknologjisë moderne për qëllim kopjimi;
- Përdorimi i softuereve që njeh plagjiaturën duhet të aplikohet rregullisht, me qëllim reduktimin të ekzistencës së detyrave të bëra me pagesë;
- Ngritja e kapaciteteve (mbi të gjitha njerëzore) për trajtimin e problemeve lidhur me korrupsionin në universitetet;
- Të konsiderohet mundësia e kryerjes së sondazheve vjetore mbi qëndrimet e studentëve në lidhje me praninë e korrupsionit në universitete;
- Të përfshihen fakultetet private, me specifikat dhe prioritetet e tyre të ndryshme, në luftën kundër korrupsionit në universitete.

2. Adoptimi, amendimi ose promovimi i akteve ligjore

- Adoptimi i rregulloreve që do të qeverisin procedurat e brendshme për pranimin e raporteve nga studentët, profesorët dhe stafi tjetër në lidhje me korrupsionin ose mundësinë e korrupsionit
- Adoptimi i rregullave për të bërë detajet e kontaktit të personelit të autorizuar për pranimin e raporteve të korrupsionit dhe të personave që bëjnë sinjalizim publikisht të disponueshme në faqen e internetit të fakultetit;
- Përgatitja e planeve vjetore për vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe publikimi i tyre;
- Vendosja e rregulloreve të brendshme për parandalimin e konflikteve të interesit dhe rregulla mbi pranimin e dhuratave në fakultetet.

3. Informimi, edukimi dhe fushata

- Aktivizimi i organeve/ndërmjetësuesve (profesorë, administratë, studentë, organizata studentore.) që merren me korrupsionin në fakultete, përmes fushatave edukative dhe workshopeve për të identifikuar format potenciale të korrupsionit si dhe si të raportohet korrupsioni në fakultet;
- Organizimi i edukimit të rinjve në lidhje me llojet e ndryshme të korrupsionit në universitet, si t'i njohin, si t'i raportojnë dhe si t'i monitorojnë;
- Inkurajimi i studentëve që të denoncojnë dhe raportojnë korrupsionin në fakultet nëpërmjet fushatave,
- Vendosja e bashkëpunimeve dhe rrjetëzimeve më aktive të studentëve përmes organizimit të aktiviteteve dhe workshopeve që do të informonin në mënyrë të konsiderueshme studentët mbi të drejtat që kanë.

Ky dokument politikash mbi "Perceptimet e korrupsionit në universitetet e Shqipërisë, Maqedonisë Veriore dhe Serbisë: Perspektivat e studentëve" është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Ballkani - Shoqëria Civile për Shoqëri të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor", i implementuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Center for Research and Policy Making (CRPM) dhe Institute for Democracy and Mediation (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme (MNPJ). Përmbytja e publikimit është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) apo të partnerëve të konsorciumit SMART Ballkan.